

## **ÇËSHËTJA SHQIPTARE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE NË BURIMET BRITANIKE (*DOKUMENTACIONI ARKIVOR, SHTYPI, MEMOARET DHE HISTORIOGRAFIA*)**

**(Albina Drançolli-Ramadani, *Çështja shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore në burimet britanike*)-(Dokumentacioni arkivor, shtypi, memoaret dhe historiografia), Artini, Prishtinë 2025)**

Monografia shkencore “Çështja shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore në burimet britanike-Dokumentacioni arkivor, shtypi, memoaret dhe historiografia, e autores Prof. Ass. Dr. Albina Drançolli - Ramadani, është një studim i thelluar dhe i mbështetur në analizë kritike. Ky studim monografik më parë është mbrojtur si tezë e doktoratës, e cila më pas është finalizuar me monografi. Autorja për përgatitjen e kësaj monografie ka hulumtuar dhe shfrytëzuar burime britanike të pabotuara, burime arkivore të botuara, shtypin ditor britanik por dhe literaturë historiografike shqiptare dhe atë ndërkom-bëtare, në Londër në The National Archives (TNA), The British Library dhe Royal Anthropological Institute of Great Britain and Ireland (RAI). Përmes koleksioneve memoare të personaliteteve të njohura britanike të kësaj periudhe, në këtë monografi janë trajtuar me kujdes qëndrimet e diplomacisë britanike ndaj çështjes shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore. Ky studim është strukturuar në shtatë kapituj dhe nënkapituj. Po ashtu, ka hyrjen, përfundimin, bibliografinë dhe shtojcën me dokumente arkivore të transkriptuara.

Kapitulli i parë me titull “*Fillimi i Luftës së Parë Botërore: Pushtimet e territoreve shqiptare gjatë viteve 1914-1915 sipas burimeve britanike*” fillon me shqyrtimin e rrethanave të përgjithshme në territoret shqiptare në prag të Luftës së Parë Botërore. Veçanërisht, qëndrimet e Britanisë së Madhe dhe mbi vendimet e diplomatëve britanikë, ndaj periudhës së qeverisjes së Princ Wied-it në Shqipëri. Studiuesja, përveç burimeve arkivore nga raportet dhe njoftimet e diplomatëve, nënkonsujve, zyrtarëve britanikë edhe përmes shtypit britanik, në këtë kapitull ofron të dhëna të detajuara për zhvillimet në vend, për dhunën dhe gjenocidin ndaj popullatës shqiptare, dëbimet, shkatërrimet, për konvertimin e dhunshëm të popullatës myslimane dhe katolike. Përveç rrethanave të cilat kishin ndikuar në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore,

autorja thekson arsyet e hyrjes në luftë të Britanisë së Madhe dhe qëndrimin e saj ndaj kombeve të vogla të Evropës, për të cilat ofron të dhëna konkrete nga deklaratat e disa personaliteteve britanike. Po ashtu, në mënyrë kronologjike përmend ndryshimet dhe zhvillimet në politikën e brendshme në Shqipëri gjatë viteve 1914-1915; arsyet e largimit të princ Wied-it nga Shqipëria më 3 shtator të vitit 1914; pushtimin e territoreve shqiptare siç ishte rasti i pushtimit të Shqipërisë së Jugut nga Greqia dhe pushtimi i Vlorës dhe Sazanit nga Italia; për negociatat dhe marrëveshjet e bëra në dëm të popullit shqiptar me nënshkrimin e Paktit të Fshehtë të Londrës më 26 prill 1915. Autorja, gjithashtu përmes disa fondeve të dokumentacionit britanik të TNA (The National Archives) dhe historiografisë britanike solli të dhëna për përgatitjet që po bënte Serbia dhe Mali i Zi për pushtimin e Shqipërisë.

Në vazhdimësinë e zhvillimit të ngjarjeve, në kapitullin e dytë "*Angazhimi i shtuar Britanik në çështjet ballkanike 1915-1916 në dritën e burimeve britanike*", autorja Albina Drançolli - Ramadani elaboron angazhimin britanik në çështjet e Ballkanit; rreth bisedimeve të Fuqive Aleate që kishin të bënin me organizimin e Misionit Britanik të Adriatikut. Si çështje tjera të veçanta të këtij kapitulli, autorja përmes disa burimeve paraqet qëndrimet e popullatës shqiptare gjatë tërheqjes serbe përmes Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë, mirëpo përmes një sërë burimesh britanike të kohës konstaton se janë kontradiktore me historiografinë serbe. Përkundër kësaj këtu u pasqyruan shkrime në *The Manchester Guardian*, pjesë të ekstrakteve nga një letër private e Alfred Stead e dërguar në *War Office*, njoftimi i Lamb dërguar diplomatit Oliphant të *Foreign Office*, raporti ushtarak i D. H. Loch nga Misioni Britanik i Adriatikut, nga ditari i Kundëradmiralit Troubridge, raporti i Gjeneralit G. F. Phillips dërguar *War Office*, njoftimet e Korrespondentit të luftës Gordon-Smith, shkrimi i Joseph Swire, deklarimi i Robert Cecil gjatë diskutimeve në Parlamentin Britanik, përkatësisht në Dhomën e Komunave, një studim i Edith Durham i botuar në *Contemporary*. Të gjitha këto dëshmojnë se nuk kishte ndonjë reagim, sulm apo ndonjë rast dhune ndaj ushtrisë serbe nga ana e shqiptarëve. Po ashtu, ky kapitull pasqyron peripecitë gjatë tërheqjes së njësiteve spitalore britanike.

"*Çështja shqiptare në vitet e luftës 1916-1917*", si kapitull më vete, i treti me radhë, është vazhdimësi e pushtimit të trojeve shqiptare. Kapitulli fillon me pushtimin e trojeve shqiptare nga okupatorë të ndryshëm, si: austro-hungarezë, bullgarë, francez dhe italianë. Është në fokus edhe mosmarrëveshja midis Austro-Hungarisë dhe Bullgarisë për okupimin e dy qyteteve të Kosovës

(Prishtinën dhe Prizrenin). Sa i përket qëndrimit të shqiptarëve ndaj pushtimit të këtyre dy aleatëve, autorja, referuar burimeve arkivore dhe historiografisë britanike, potencon se shqiptarët i përkrahnin austro-hungarezët. Sidomos, historiografia bashkëkohore dhe ajo e kohës, sipas autores, gjatë okupimit austro-hungarez në Kosovë ishin hapur një numër i madh shkollash, në administratë ishin emëruar zyrtarë shqiptarë dhe ishte lejuar gjuha shqipe. Për gjendjen e njëjtë thekson se ekzistonte edhe në Shqipërinë Veriore dhe të Mesme gjatë vitit 1916. Në këtë rast trajtohen edhe rrethanat e vrasjes së Isa Boletinit në vitin 1916 dhe përshtypja e disa miqve britanikë ndaj tij; diskutimet dhe iniciativa rreth negociatave për themelimin e një regjimenti nga shqiptarët e Amerikës; rreth tendencës së Serbisë për vendosjen e administratës serbe në Pogradec dhe qëndrimin e qeverisë britanike rreth çështjes së riokupimit.

*“Shqipëria në vitin e fundit të Luftës së Parë Botërore”*, që shënon kapitullin e katërt, ka në fokus gjendjen në të cilën ndodhej Shqipëria, pozitën gjeografike të saj, përcjellja e ngjarjeve nga qarqet diplomatike britanike, planet e ndryshme rreth interesimit për marrjen e disa territoreve shqiptare, konkretisht planifikimi i Austro-Hungarisë për ndarjen e Shqipërisë në pjesën jugore dhe veriore, si dhe pretendimi i italianëve për riokupimin e Korçës në fund të Luftës së Parë Botërore; luftimet mes dy blloqeve të Fuqive të Mëdha në përfundim të luftës, kontributin e shqiptarëve në luftë në përkrahje të Antantës; rëndësinë e qytetit të Vlorës dhe të Durrësit, luftimet dhe interesat për pushtimin dhe marrjen e këtyre dy qyteteve. Duke folur për gjendjen e Shqipërisë me përfundimin e luftës dhe situatën pas saj, vëmendje të veçantë i kushtohet gjithashtu shpërbërjes së Komitetit Shqiptar dhe formimit të Shoqërisë Anglo-Shqiptare, e cila si qëllim kishte mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e Shqipërisë, si dhe për kontributin e dhënë ndaj kësaj shoqërie.

Miti për Betejën e Kosovës ka zënë vend të veçantë në kapitullin e pestë me titull *“Miti i Betejës së Kosovës (1389) në kontekst të propagandës proserbe në Britani të Madhe 1914-1918”*. Në këtë rast është pasqyruar edhe mitizimi që i bëhej Betejës së Kosovës në Britani të Madhe gjatë Luftës së Parë Botërore. Këndvështrimin e Britanisë së Madhe, përkrahjen dhe përkushtimin e personaliteteve politike, publicistike e fetare, por edhe të studiuesve dhe historianëve britanikë që kishin për Serbinë, për entuziazmin dhe manifestimet dhe aktivitetet që bënin për përvjetorin e Betejës së Kosovës dhe efektet e arritjes së shënimit të kësaj dite për Serbinë, për rëndësinë e shtypit britanik ndaj kësaj beteje.

Mirëpo, përveç gjithë zhvillimeve e rrethanave të krijuara gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore sipas burimeve britanike, autorja këtë monografi e ka pasqyruar edhe me njoftime për historinë, gjuhën dhe kulturën e popullit shqiptar. Këto janë trajtuar në kapitullin e gjashtë *“Njoftime mbi historinë, gjuhën dhe kulturën shqiptare në burimet britanike 1914-1918”*. Në këtë kontekst shtjellohen më hollësisht çështja e autoktonisë së shqiptarëve dhe prejardhja e tyre, gjuha, kultura, organizimi shoqëror dhe zakonet e tyre sipas vështrimeve të diplomatëve, studiuesve apo udhëpërshkruesve britanikë. Në kuadër të zakoneve në këtë kapitull, studiuesja Drançolli - Ramadani trajton hollësisht Gjakmarrjen dhe Besën të shqiptarët sipas studiuesve të huaj.

Kapitulli i shtatë dhe i fundit *“Çështja shqiptare në vorbullën e zgjidhjeve finale territoriale në Evropë-memorandume dhe propozime të zyrtarëve dhe studiuesve britanikë”*, përveç çështjes së rregullimit të kufijve të rinj evropianë, trajtohet veçanërisht edhe çështja e territoreve shqiptare në disa memorandume dhe propozime të disa prej zyrtarëve dhe studiuesve britanikë, gjatë dhe në përfundim të Luftës së Parë Botërore. Disa prej memorandumeve dhe propozimeve të trajtuara në këtë kapitull, autorja thekson memorandumimin nga Ralph Paget dhe W. Tyrrell, propozimin nga Shtabi i Përgjithshëm, Zyra e Luftës, idetë dhe propozimet e historianit britanik Arnold J. Toynbee, propozimet e kolonelit Sir Thomas H. Holdich. Përmbyllëse e këtij kapitulli është përmbajtja e publikimeve të Lidhjes Anglo-Helenike kundër shqiptarëve dhe propagandimi i saj në favor të grekëve.

Prof. Ass. Dr. Albina Drançolli-Ramadani, duke u bazuar në dokumentacionin arkivor dhe shtypin britanik, por duke e plotësuar dhe me historiografi, në mënyrë analitike ka sjellë para lexuesve, studentëve dhe historiografisë një vepër të mirëfilltë shkencore. Përmes kësaj monografie shkencore ofrohen të dhëna të detajuara për të kaluarën e popullit shqiptar, konkretisht gjatë Luftës së Parë Botërore 1914-1918. Është një referencë shtesë përmes së cilës me shpalosjen e faqeve të kësaj monografie do të informohemi për zhvillimet e ngjarjeve të shumta të territoreve shqiptare gjatë kësaj periudhe, si në aspektin historik, politik, ekonomik, kulturor e shoqëror.

**Ardita HAJDARI-BUQINCA**